

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR ME NJË ORTAK**  
**"TEA LONDON" SHPK**

Sot me daten 06.09.2025 (dymijë e njëzet e pesë), me ortakun themelues :

- **Z.RRAPO ZOTAJ** shtetas shqipëtar, i datëlindjes 02 Gusht 1992, lindur në Ballsh dhe banues në Durrës , person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues i Leternjoftimit (kartë identiteti) me Nr J20802101N

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar me nje ortake " TEA LONDON" SHPK.

**NENI 1.**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të quhet " TEA LONDON" SHPK.

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, "Durrës,Lagjia.13,Rruga Pavaresia,Plazh me nr pasurie 26/84-N7, Zone Kadastrale 8518.

**NENI 3**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Tregti,import-eksport automjesh te tonazheve te ndryshme dhe motorash elektrik. Dhenie Automjete me qera,motora me qera.Transport kombetar dhe nderkombetar mallrash dhe udhetaresh.Agjensi komisionere per punetore, agjensi marketingu, marketing,reklamim ne rrjetet sociale, ,menaxhim kanalesh youtube, hapje faqesh web.Agjent i shoqerise easypay shpk (institucion i parase elektronike) per kryerjen e sherbimeve qe perfshijne por nuk kufizohen ne pagesa faturash & transferta parash,shitje te mallrave/sherbimeve te partnereve te easy pay,rimbushje telefonike.Agjent ne Sigurime.Rimbushje elektronike. Agjensia Western Union. Rimbushje One, Vodafone, Digitalb, Pagesa Oshee, UKD. Shitje Cigare. Agjensi Imobiliare, Zyre ndermjetesimi per shitje pasurish te tundshme dhe te patundshme, Sherbim Klienti,Sherbime Marketingu,Blerje, dhenie me qera, ,kryerja e te gjitha sherbimeve ne lidhje me



pasurite e paluajtshme, asistence per regjistrimin e pasurive te paluajtshme prane ZVRPP, konsulence ligjore per shitblerje.

### **KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë "TEA LONDON Shpk" është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në 1 kuotë, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kontributi i ortakeve është i ndare si vijon:

#### **1. Z.Rrapo Zotaj zotëron 1 kuotë baras me 100 % të kapitalit.**

### **NENI 5**

#### **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

### **NENI 6**

#### **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administratori i shoqërisë do të jetë **z.Rrapo Zotaj** i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmën e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

### **NENI 7**

#### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqëritë Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **NENI 8**

### **NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

### **Neni 9**

#### **LIKUJDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

### **NENI 10**

#### **MOSMARRËVESHJET**

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

**ORTAKU THEMELUES ISHOQËRISË  
" TEA LONDON" SH.P.K**

**RRAPO ZOTAJ**

RRAPO ZOTAJ

